

**PROTOKOLLI I MIRËKUPTIMIT
PËR KRIJIMIN E KOMITETIT TË PËRBASHKËT
MBI
ÇËSHTJET DOGANORE
MIDIS
DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË DOGANAVE TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
DHE
MINISTRISË SË DOGANAVE DHE TREGTISË TË REPUBLIKËS SË
TURQISË**

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave e Republikës së Shqipërisë dhe Ministria e Doganave dhe Tregtisë të Republikës së Turqisë (në vijim referuar me “Palët”);

NË FRYMËN E Marrëveshjes për Bashkëpunimin dhe Ndihmën e Ndërsjellë në Çështjet Doganore midis Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë, nënshkruar në Ankara, Turqi, më 12 shkurt 1998;

DUKE KONFIRMUAR marrëdhënien bashkëpunuese të krijuar midis Palëve, të cilat do të jenë autoritetet kompetente për zbatimin e këtij Protokolli Mirëkuptimi;

DUKE NJOHUR rëndësinë e rolit të Doganave në mbrojtjen e kufirit dhe promovimin e rritjes ekonomike duke lehtësuar tregtinë;

DUKE VËREJTUR që angazhimi i Palëve për të shkëmbyer informacion ndihmon në promovimin e flukseve bilaterale të mallrave, shërbimeve, kapitalit dhe burimeve njerëzore;

Duke ripohuar vlerën e lartë të dialogut intensiv midis Palëve në angazhimin për të bashkëpunuar edhe më tej në çështjet doganore;

Kanë rënë dakord për sa më poshtë vijon:

NENI 1

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

- 1) Palët do të krijojnë një Komitet të Përbashkët Doganor (në vijim referuar me “Komiteti”) midis Administratës Doganore të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Turqisë për të promovuar bashkëpunimin në çështjet doganore.

- 2) Komiteti do të udhëhiqet nga Marrëveshja midis Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Turqisë në lidhje me Ndihmën e Ndërsjellë midis Administratave të tyre Doganore, nënshkruar në Ankara, Turqi, më 12 shkurt 1998, dhe do të kryejnë funksionet e tyre sipas Protokollit në fjalë.
- 3) Rritja e bashkëpunimit në të gjitha aspektet midis Administratës Doganore të Shqipërisë dhe Turqisë do të kryhet brenda kuadrit të Komitetit dhe grupeve të tij të punës.

NENI 2

FUNKSIONET E KOMITETIT TË PËRBASHKËT

- 1) Komiteti do të koordinojë, nxitë dhe rritë bashkëpunimin në çështjet doganore midis Palëve si dhe do të përcaktojë fushat kryesore dhe drejtimet e bashkëpunimit.
- 2) Komiteti koordinon bashkëpunimin midis Palëve në fushat e mëposhtme:
 - a) Shqyrton mënyrat dhe mundësitë për të hapur rrugën për të intensifikuar bashkëpunimin në çështjet doganore midis Palëve;
 - b) Bashkëpunon nëpërmjet angazhimit të përbashkët në mënyrë që të lehtësojë, thjeshtojë dhe sigurojë pikat e kalimit kufitar dhe të sigurojë formalitete efikase doganore;
 - c) Ndan përvojat mbi njohuritë dhe praktikat më të mira në lidhje me politikat dhe procedurat doganore, funksionet e zbatimit, programet e modernizimit dhe sigurinë e zinxhirit të furnizimit;
 - d) Zhvillimin dhe përmirësimin e teknologjive të përdorura në procedurat doganore dhe ekzaminimet doganore me qëllim që të sigurojë saktësinë e të dhënave mbi mallrat e zhvendosur;
 - e) Zbatimin e projekteve me qëllim që të rritë efikasitetin e kontroleve doganore dhe lehtësojë procedurat doganore duke shkëmbyer informacion;
 - f) Bashkëpunim në zbatimin e ligjit për çështjet doganore, veprime të shpejta bilaterale kundër kontrabandës dhe mbrojtjes së të drejtave të pronësisë intelektuale;
 - g) Fusha të tjera bashkëpunimi në çështjet doganore.

NENI 3

STRUKTURA E KOMITETIT TË PËRBASHKËT

- 1) Palët do të caktojnë anëtarët e tyre të Komitetit dhe do të informojnë njëri – tjetrin për çdo ndryshim
- 2) Drejtuesit e Administratave Doganore të të dyja Palëve do të jenë bashkë-Drejtues të Komitetit;
- 3) Drejtuesit e sektorëve të strukturës së Administratave Doganore në fjalë do të jenë drejtuesit e grupeve të punës të Komitetit, sipas rasteve.
- 4) Personeli Doganor do të marrë pjesë si anëtar në takimet e Komitetit dhe në takimet e Grupit të Punës, sipas rasteve.
- 5) Pozicionet e përcaktuara në paragrafët e mësipërm, 2 dhe 3, mund t'iu delegohen anëtarëve të tjerë të delegacionit me kusht që Pala tjetër të jetë informuar në mënyrën e duhur.
- 6) Krijimi i Grupeve të Punës brenda kuadrit të Komitetit do të jetë:
 - a) Grupe pune shqiptaro-turke për bashkëpunimin ndërkombëtar dhe trajnimin.
 - b) Grupe pune shqiptaro-turke për bashkëpunimin në zbatimin e ligjit në çështjet doganore,
 - c) Grupe pune shqiptaro-turke për menaxhimin e riskut dhe kontrollin doganor,
 - d) Grupe pune shqiptaro-turke për teknologjinë e informacionit.
- 7) Gjithashtu mund të krijohen grupe të tjera pune për rritjen e bashkëpunimit dhe në rast nevojë për të bashkëpunuar në fusha të tjera.
- 8) Grupet e punës do të udhëhiqen nga Protokollin në fjalë dhe vendimet e marra në takimet e Komitetit. Grupet e Punës do të raportojnë rregullisht te Komiteti mbi rezultatet e punës së tyre.

NENI 4

TAKIMET E KOMITETIT TË PËRBASHKËT

- 1) Takimet e Komitetit do të zhvillohen njëherë në vit, me radhë, në Republikën e Shqipërisë dhe në Republikën e Turqisë.
- 2) Data e takimit dhe objekti i diskutimeve do të negociohet nga Palët të paktën një muaj para takimit. Çështje të tjera mund të propozohen nga Drejtuesit e Komitetit dhe mund të ngrihen gjatë diskutimeve.
- 3) Në lidhje me çështjet e diskutuara në Komitet, nëse është e nevojshme, secila Palë mund të ftojë ekspertët dhe përfaqësuesit e organeve të tjera qeveritare të marrin pjesë në takime.
- 4) Përfaqësuesit e Palëve, për çështje urgjente, mund të mbajnë konsulta midis takimeve të rregullta të Komitetit dhe të miratojnë vendime të përbashkëta mbi çështjen e diskutuar dhe ta futin në Protokoll në takimin më të afërt të Komitetit.
- 5) Çdo vendim i miratuar në takimet e Komitetit, i cili do të nënshkruhet nga Drejtuesit e Komitetit në fund të takimit të Komitetit do të arkivohet.
- 6) Gjuha e punimeve të Komitetit dhe nën organeve të tij do të jetë gjuha zyrtare e Palëve dhe gjuha angleze, sipas rastit. Çdo dokument i prodhuar nga Komiteti do të jetë në Anglisht. Megjithatë, dokumentet në gjuhët zyrtare të Palëve mund të prodhohen vetëm ose duke shoqëruar versionin anglisht me kusht që të ekzistojë pëlqimi reciprok.

NENI 5

SEKRETARITI

- 1) Detyrat e sekretariatit për Komitetin do të merren përsipër nga sektorët përkatës të Administratës Doganore përgjegjëse për punët e jashtme.
- 2) Sekretariati do të sigurojë mbështetjen administrative për zhvillimin e takimeve.
- 3) Sekretariati do të ruajë punën e zakonshme të Komitetit dhe do të koordinojë punën e nën organeve të Komitetit.
- 4) Përfaqësuesit e Sekretariatit nga Palët duhet të kontaktojnë rregullisht me njëri-tjetrin dhe, në së gjykohet e nevojshme, mund të mbajnë takime midis takimeve të Komitetit.

NENI 6

SHPENZIMET FINANCIARE TË KOMITETIT TË PËRBASHKËT

- 1) Shpenzimet për përgatitjen dhe realizimin e takimeve të Komitetit do të mbahen nga Pala pritëse. Shpenzimet e udhëtimit për pjesëmarrësit në takimet e Komitetit do të mbulohen nga vetë Palët.
- 2) Secila Palë mbulon të gjitha shpenzimet e nevojshme në lidhje me aktivitetet e anëtarëve të saj të Komitetit.

NENI 7

MARRËVESHJE TË TJERA

Dispozitat e Protokollit në fjalë nuk do të cenojnë të drejtat dhe detyrimet e Palëve që rezultojnë nga marrëveshje të tjera ndërkombëtare në të cilat ata janë shtet anëtar.

NENI 8

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

- 1) Çdo mosmarrëveshje që mund të dalë nga interpretimi ose aplikimi i këtij Protokollit do të zgjidhet nëpërmjet negociatave dhe konsultimeve midis Palëve. Çështjet e pazgjidhura nëpërmjet këtij procesi do të zgjidhen nëpërmjet kanaleve diplomatike.
- 2) Secila Palë mund të kërkojë konsultim me Palën tjetër në lidhje me interpretimin, zbatimin dhe ndryshimet e këtij Protokollit ose zgjidhjen e çdo konflikti të mundshëm që mund të shfaqet. Konsultimet që do të kryhen midis Palëve do të fillojnë brenda 20 ditëve pas marrjes së kërkesës me shkrim, me përjashtim të rastit nëse vendoset ndryshe.

NENI 9

SHTESA DHE NDRYSHIME

Këtij Protokollit mund t'i bëhet çdo shtesë dhe ndryshim nëpërmjet miratimit të ndërsjellë të Palëve. Këto shtesa dhe ndryshime do të bëhen në formën e Protokolleve të ndara të cilat do të jenë pjesë integrale e këtij Protokollit dhe do të hyjnë në fuqi në përputhje me dispozitat e nenit 10 të këtij Protokollit.


NENI 10

HYRJA NË FUQI, KOHËZGJATJA DHE PËRFUNDIMI

- 1) Protokollin në fjalë do të hyjë në fuqi në ditën e tridhjetë të marrjes së njoftimit të fundit me shkrim nëpërmjet të cilit Palët njoftojnë njëra-tjetrën, nëpërmjet kanaleve diplomatike, për përfundimin e procedurave të tyre të brendshme ligjore të kërkuara për hyrjen në fuqi të dokumentit në fjalë.
- 2) Ky Protokoll do të mbetet në fuqi për 10 (dhjetë) vjet nga data e hyrjes së tij në fuqi dhe do të rinovohet për dhjetë vjet me përjashtim të rastit nëse njëra nga Palët njofton me shkrim Palën tjetër, nëpërmjet kanaleve diplomatike, për qëllimin e saj për të përfunduar Protokollin 6 muaj para datës së përfundimit.
- 3) Secila Palë mund të përfundojë këtë Protokoll duke dërguar një njoftim me shkrim të qëllimit të saj për të përfunduar Protokollin. Në raste të tilla, Protokollin do të përfundojë tre muaj pas datës së këtij njoftimi.
- 4) Përfundimi i këtij Protokollin nuk do të ndikojë aktivitetet dhe projektet tashmë në zhvillim ose të zbatuara.
- 5) Kryer në Ankara, më 06.04.2016, në dy kopje origjinale, secila në gjuhën shqipe, turke dhe angleze, duke qenë të gjitha tekstet njëjloj autentike.
- 6) Në rast mosmarrëveshjeje nga interpretimi i këtij Protokollin, përparësi do të ketë teksti në anglisht.

**PËR DREJTORINË E
PËRGJITHSHME TË
DOGANAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË**

PRANVERA FAÇU (BEHUSHI)
Drejtore e Përgjithshme



**PËR MINISTRINË E
DOGANAVE DHE TREGTISË TË
REPUBLIKËS SË TURQISË**

CENAP AŞCI
Sekretar i Përgjithshëm

